



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 85 datë 30.10.2018

Për

**FILLIMIN E PROCEDIMIT ADMINISTRATIV PËR ZGJIDHJEN E
MOSMARRËVESHJES SË INTERKONEKSIONIT MIDIS NISATEL SH.P.K. DHE
ALBTELECOM SH.A.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Edlira	Dvorani	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare znj. Ina Nuellari, në mbledhjen e datës 30.10.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP dhe Rregulloren nr. 18, datë 11.06.2010 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve” shqyrtoi çështjen me objekt:

Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Nisatel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.

BAZA LIGJORE:

1. Ligji nr. 9918, datë 19.05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**Ligji nr. 9918**);
2. Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së

Shqipërisë” (ligji nr. 44/2015);

3. Rregulloren e Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP;
4. Rregulloren nr. 18, datë 11.6.2010 “Për procedurat e zgjidhje së mosmarrëveshjeve”;
5. Rregulloren nr. 19, datë 14.6.2010 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, e ndryshuar;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa e Nisatel, Nr. 2124/9 Prot, datë 23.10.2018, “Kërkesë për ndërhyrje për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Albtelecom sh.a dhe Nisatel shpk”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a., Nr 8013/5 Prot, datë 18.10.2018, “Njoftim mbi pezullimin e shërbimeve të interkoneksionit për shkelje të pagesës së faturës për korrigjimin e dëmit të shkaktuar nga Nisatel shpk në shkelje të marrëveshjes së interkoneksionit”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a., Nr 8013/2 Prot, datë 21.09.2018, “Njoftim mbi korrigjimin e shkeljes, shlyerjen e dëmit financiar dhe pezullimin e shërbimeve të interkoneksionit-drejtuar operatorit Nisatel”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a., Nr. 8013/4 Prot, datë 12.10.2018, “Mbi ridërgimin e faturës për korrigjimin e dëmit të shkaktuar në shkelje të Marrëveshjes së Interkoneksionit”;
- Shkresa e Nisatel sh.p.k., Nr. 952 Prot, datë 09.10.2018, “Kthim fature tatimore shitje drejtuar Albtelecom”;
- Shkresa e Nisatel sh.p.k., Nr. 823 Prot, datë 24.08.2018, “Kthim përgjigje për Albtelecom për shkresën Nr. 8013, datë 13.08.2018;
- Shkresa e Albtelecom sh.a., Nr. 8013 Prot, datë 13.08.2018, “Njotim për shkelje-përdorim abuziv të Marrëveshjes së Interkoneksionit-drejtuar Nisatel”;
- Kopje të faturës tatimore të shitjes lëshuar nga Albtelecom për Nisatel;
- Tabela me llogaritjet e detajuara për trafikun në shkelje të MI për seritë numerike 33414xxx – 33419xxx (3319 CLI);
- Komunikimi elektronik ndërmjet dy subjekteve nga skuadrat përkatëse të interkoneksionit;
- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (*Relacioni*),

si dhe duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N se:

Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore, pasi mori në shqyrtim kërkesën e sipërmarrësit Nisatel sh.p.k. me shkresë Nr. 3 Prot, datë 22.10.2018 (Nr. 2124/9 Prot. i AKEP, datë 23.10.2018), “Kërkesë për ndërhyrje për zgjidhjen e mosmarrveshjes midis Altelecom sh.a dhe Nisatel shpk”, si dhe materialin shkresor të bashkëlidhur kësaj kërkesë, propozon për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Nisatel sh.p.k. dhe Altelecom sh.a”, pasi konstatohet se:

Pavarësisht korespondencës shkresore të zhvilluar ndërmjet palëve Altelecom dhe Nisatel, komunikimit elektronik të zhvilluar ndërmjet stafeve teknike të dy sipërmarrësve, mosmarrëveshja ndërmjet palëve përmbledhet sipas pikave më poshtë:

- Prej datës 20-23 Korrik 2018 nga ana e Altelecom është iniciuar një korespondencë me anë të email-eve dhe më pas shkresave zyrtare për përdorim abuziv të Marrëveshjes së Interkoneksionit nga subjekti “Nisatel sh.p.k.”, duke referuar për këtë prova dhe fakte të materializuara dhe proceduralisht sipas kërkesave të Rregullores Nr. 19 datë 14.06.2010 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, duke referuar shkeljen përkatës dhe marrjen e masave për korrigjim nga subjekti “Nisatel shpk”, i pretenduar në shkelje;
- Mbështetur në Marrëveshjen e Interkoneksionit Nr. 3093 Prot, datë 08.04.2015, të referuar nga Altelecom, në parashikimet e nenit 15, specifikisht pika 5 dhe 8 e saj, si dhe nenit 23, pika 2 dhe 3, lidhur me përdorimin abuziv të Marrëveshjes, Altelecom sh.a. ka njoftuar Nisatel sh.p.k. se trafiku për 3319 CLI është në shkelje të kushteve të Marrëveshjes së lidhur mes palëve për periudhën Maj-Korrik 2018 për përdorimin e shërbimeve të interkoneksionit në kundërshtim me qëllimin për të cilin është ofruar duke krijuar përfitime të padrejta nga kjo marrëveshje;
- Në zbatim të Marrëveshjes së Interkoneksionit midis palëve, Altelecom kërkon që brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit fillestar nga Nisatel, të paraqiten provat sipas përcaktimeve në nenin 15, pika 7, konkretisht:
 - Kopjet e kontratave të pajtimtarëve nga numri i të cilëve janë gjeneruar thirrjet (gjithsej 3319 CLI);
 - Faturat Muajore; të muajve Maj, Qershor, Korrik, për secilin nga numrat telefonikë të Nisatel që kanë gjeneruar këtë trafik (3319 CLI bashkëngjitur në CD) drejt rrjetit Altelecom Fiks/Mobil;
 - Dëftesën tatimore që Nisatel paguan pranë organeve tatimore për faturat e abonentëve për muajt Maj-Korrik 2018 të numrave të serive numerike (3319 CLI) që kanë realizuar trafik telefonik drejt rrjetit Fiks/Mobil Altelecom duke i bashkëngjitur njoftimin, informacionin në CD.
- Në referencë me shkeljet e cituara më sipër, Altelecom faturon shërbimet përkatëse për kompensimin e dëmit financiar të shkaktuar duke ja dërguar zyrtarisht Nisatel shpk, përkundrejt njoftimit përkatës dhe detyrimeve që rrjedhin nga MI ndërmjet palëve;
- Për situatën e krijuar, Nisatel sh.p.k. shpjegon se ka pasur komunikime me e-mail dhe shkresa zyrtare me Altelecom duke argumentuar se shqetësime të kësaj natyre (teknike) ka patur midis palëve në vazhdimësi dhe janë zgjidhur me ndërhyrjet e nevojshme në bashkëpunim midis palëve, pa cënuar mbarëvajtjen dhe vazhdimësinë e marrdhënieve të

interkoneksionit dhe i konsideron si egzagjerim pretendimet e Albtelecom, duke pretenduar se ka paraqitur shpejgime dhe prova të mjaftueshme për këtë qëllim si dhe anagazhim për rregullimin e problemeve teknike, me qëllim mbarëvajtjen e marrëdhënieve për shërbimet e interkoneksionit.

Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore, pasi shqyrtoi dokumentacionin e sipërcituar, gjykon se:

- Kërkesa për zgjidhje mosmarrëveshje” nga ana e Nisatel shpk është paraqitur sipas kushteve formale-juridike të parashikuar në Rregulloren nr.18, datë 11.06.2010 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”.
- Objekti i mosmarrëveshjes për të cilin AKEP kerkohet të investohet, është brenda kompetencës lëndore të tij sipas parashikimeve në Rregulloren nr.18, datë 11.06.2010 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, Rregulloren nr.19, date 14.06.2010 për “Aksesin dhe Interkoneksionin”.

Kështu që, nisur nga parashtrimi i bërë në kërkesën përkatëse nga sipërmarrësi Nisatel sh.p.k., sipas shkresës me nr. 2124/9 Prot, datë 23.10.2018, “Kërkesë për ndërhyrje për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Albtelecom sh.a. dhe Nisatel sh.p.k.”, përmban informacionin e kërkuar të përshkruar në “Rregulloren nr. 18, datë 11.6.2010 për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet sipërmarrësve”, dhe konsiderohet se përmbush kushtet ligjore për pranimin e kërkesës dhe shqyrtimin e mosmarrëveshjes nga AKEP-i duke proceduar administrativisht, sipas parashikimit në nenin 120 të Ligjit nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe rregulloret e nxjerra në zbatim të tij.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të procedurës së përcaktuar në Ligjin nr.9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 114, neni 115 si dhe Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (ligji nr. 44/2015) neni 130 e në vijim,

V E N D O S:

1. Të fillojë procedimim administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Nisatel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.
2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjes sipas procedurës dhe afateve të përcaktuara në Rregulloren nr. 18 të datës 11.06.2010, me përbërje si:
 - Nuredin Hasanaj Kryetar
 - Rajmonda Çelirama Anëtar

- Aleksander Ypi Anëtar
 - Livia Rrokaj Anëtar
 - Gezim Peposhi Anëtar
3. Ngarkohet Komisioni për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve për njoftimin e palëve të interesuara Nisatel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a., për fillimin e procedimit administrativ dhe ndjekjen e procedurave;
 4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 7 ditëve nga marrja e Vendimit;
 5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

Ilir Zela

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Edlira DVORANI**
3. **Ketrin TOPÇIU**
4. **Klarina ALLUSHI**